


5. Kanguri Kengu gjithmonë bën një kërcim të gjatë dhe pastaj dy kërcime të shkurtra në vijë të drejtë, si në figurë.

Kengu fillon kërcimin në numrin 0 dhe e përfundon në numrin 16. Sa kërcime ka bërë Kengu?



- (A) 4 (B) 7 (C) 8 (D) 9 (E) 12

3	2	5	4	2	1
1	4	3	1	3	4
2	5		5	2	1
4	1				3
3	2	4	2	5	2
4	1	3	1	3	4

6.

Ana ndërton një lojë me formuese, ku dy katrorë me brinjë të përbashkëta nuk kanë të njëjtin numër. Cilën nga formueset e mëposhtme duhet të vendosë ajo për ta përfunduar lojën?

- (A) (B) (C) (D) (E)


7. Cila nga dyshet e mëposhtme mund të vendoset në dy kutitë boshe të barazimit

$$2022 + \square = 2020 + \square$$

në mënyrë që ai të jetë i vërtetë?

- (A) 3 dhe 5 (B) 4 dhe 1 (C) 3 dhe 4 (D) 7 dhe 2 (E) 9 dhe 8

8. Joni ndërtoi kullën e treguar në figurë.




Cilën pamje shikon ai nëse kullën e vështron nga sipër?

- (A) (B) (C) (D) (E)

Problema me 4 pikë


9. Pesë makina me numrat 1, 2, 3, 4 dhe 5 janë duke lëvizur në të njëjtin drejtim.



Në fillim, makina e fundit (5) i parakalon (lë pas) dy makinat përpara saj.
 Pastaj, makina e parafundit i parakalon (lë pas) dy makinat përpara saj.
 Në fund, makina në mes i parakalon (lë pas) dy makinat përpara saj.
 Në çfarë renditje janë makinat tani?






- (A) 1, 2, 3, 5, 4 (B) 2, 1, 3, 5, 4 (C) 2, 1, 5, 3, 4 (D) 3, 1, 4, 2, 5 (E) 4, 1, 2, 5, 3

10. Moshat e një familjeje kangurësh janë 2, 4, 5, 6, 8 dhe 10 vjeç. Shuma e moshave të katër prej tyre është 22 vjeç. Sa vjeç janë dy kangurët e tjerë?



- (A) 2 dhe 8 (B) 4 dhe 5
 (C) 5 dhe 8 (D) 6 dhe 8
 (E) 6 dhe 10

11. Gjatë pushimeve unë u dërgova pesë kartolinat e mëposhtme shokëve të mi. Dihet që në kartolinën e Marinit **nuk** ka rosa. Kartolina e Sarës përmban diellin.
 Në kartolinën e Valbonës janë saktësisht dy gjallesa. Kartolina e Laurës ka një qen në të. Në kartolinën e Hanës ka kangurë. Cilën kartolinë mori Marini?




12. Martini dëshiron që shuma e tre numrave në secilin rresht dhe në secilën shtyllë të tabelës të jetë e njëjtë. Ai ka bërë një gabim. Cilin numër duhet të ndryshojë ai?

- (A) 1 (B) 3 (C) një nga numrat 4
 (D) 5 (E) një nga numrat 7

9	1	5
3	7	6
4	7	4


13. Aladini ka një qilim katror. Në këtë qilim janë vendosur dy radhë përgjatë çdo ane të qilimit me numër të njëjtë pikash në to. Fatkeqësisht, qilimi është palosur pjesërisht.



Sa pika ka në qilimin e Aladinit?

- (A) 48 (B) 44 (C) 40 (D) 36 (E) 32

14. Jona e palosi katrorin me numra dy herë, siç tregohet në figurë. Pastaj ajo hapi një vrimë nëpër njollën e zezë të treguar me shigjetë. Nëpër cilët numra kalon kjo vrimë?




- (A) 8, 11, 26, 29 (B) 14, 17, 20, 23 (C) 15, 16, 21, 22
 (D) 14, 16, 21, 23 (E) 15, 17, 20, 22

15. Në një klasë nxënësit janë ulur nëpër rreshta. Çdo rresht ka numër të njëjtë nxënësish. Roni ka përpara 2 rreshta me nxënës dhe mbrapa ka një rresht. Në rreshtin e Ronit janë 3 nxënës në anën e majtë të tij dhe 5 nxënës në anën e djathtë të tij. Sa nxënës janë gjithsej në klasë?

- (A) 10 (B) 17 (C) 18 (D) 27 (E) 36

16. Kubi i treguar në figurë është ndërtuar nga tre lloje blloqesh druri. Sa blloqe të bardha druri janë përdorur?




- (A) 8 (B) 11 (C) 13 (D) 16 (E) 19

Problema me 5 pikë

17. Vera zgjodhi disa nga figurat e mëposhtme dhe tha “Ndër figurat që kam zgjedhur 2 janë të ngjyrosura, 2 janë të mëdha dhe 2 janë të rrumbullakëta”.

Sa është numri më i vogël i figurave që mundi të zgjedhë Vera?



- (A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 6

